

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Altin Krasniqi zbulon mesazhet e të atit gjatë takimeve në Hagë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/altin-krasniqi-zbulon-mesazhet-e-te-atit-gjate-takimeve-ne-hage/1013139/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 18:07:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:04:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8fdb6120bda1e74b376545462429ed02ab0ffc2e8f357f6fc6024ddd459d4571
TEKSTI	dacdb10d3ecd7c314678f494a3504882e34f1f47bbd12cefe9107a14c132f6f9
PAMJA	a0659b867938b6654b63d5aee4921bd0d53f26d865b36dddc201ec1ccf1d27f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	36ebd01ab525e281bba86d031dec714e0e1b602146c2060ebd830862098ab983
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcf62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/36ebd01ab525e281bba86d031dec714e0e1b602146c2060ebd830862098ab983>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Altin Krasniqi zbulon mesazhet e të atit gjatë takimeve në Hagë



Më pak se 15 orë para se Gjykata Speciale të shpallë aktgjykimin e shkallës së parë ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, deklaroi se këto janë momente me peshë të jashtëzakonshme.

Ai shprehu bindjen se UÇK-ja ka zhvilluar një luftë të drejtë dhe të pastër, ndërsa drejtuesit e saj kanë luftuar për dinjitetin e popullit shqiptar.

Duke folur për vizitat në Hagë, Altin Krasniqi tha se i ati, Jakup Krasniqi, në çdo takim u ka dhënë forcë dhe kurajë. Sipas tij, Jakup Krasniqi ka theksuar se jo vetëm lufta e tij, por edhe ajo e çdo ushtari dhe e secilit që po gjykohet, ka qenë në shërbim të lirisë dhe dinjitetit të shqiptarëve.

"Në çdo takim me babanë, ai na ka motivuar dhe na ka dhënë kurajë. Na ka thënë se lufta e UÇK-së, jo vetëm e tij, por e çdo ushtari dhe e secilit që po gjykohet këtu, ka qenë e drejtë dhe është bërë për dinjitetin e për lirinë e popullit shqiptar. UÇK-ja ka zhvilluar luftë të pastër dhe asnjë vendim nuk mund ta zhbëjë krenarinë që ky popull ndien për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", deklaroi Krasniqi për KosovaPress.

Ai tregoi gjithashtu se e ka ëndërruar lirinë e të atit dhe se familja ndien dhimbje për qëndrimin e tij në paraburgim. Megjithatë, sipas Altin Krasniqit, dhimbja do të ishte shumë më e madhe nëse Jakup Krasniqi nuk do të kishte qenë pjesëtar i UÇK-së.

"Sigurisht që e kam ëndërruar lirinë e tij dhe jam jashtëzakonisht krenar për rrugën që ka zgjedhur babai im. Është normale të ndiej dhimbje, por dhimbja më e madhe për mua do të ishte sikur ai të mos kishte qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e procesit të shtetndërtimit të Kosovës. Për këtë arsye jam krenar dhe, pavarësisht vendimit që do të merret sot, ai dhe shokët e tij do të mbeten heronjtë e Kosovës dhe krenaria jonë", u shpreh ai.

të fundit /



Altin Krasniqi zbulon mesazhet e të atit gjatë takimeve në Hagë



AAK diskuton zhvillimet politike dhe vendimin e pritshëm në Hagë



Xhaka synon finalen me Sunderlandin: Dy herë kam dështuar, d...



Masa të shtuara sigurie në Hagë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së



Lladrovci fton qytetarët e Drenasit ta presin së bashku vendimin e...



Protestuesi denoncon dhunën në komisarjat: Më rrahën efektivët,...



Juristët britanikë: Masat ndaj Izraelit nuk i përbushin detyrimet...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Krasniqi bëri të ditur se familja dhe pjesëtarët e ekipit mbrojtës do ta apelojnë çdo vendim që nuk është në favor të ish-krerëve të UÇK-së. Nëse aktgjykimi nuk do të jetë pozitiv, ai kërkoi që situata të përballohet me qetësi dhe maturi.

"Duhet të qëndrojmë të bashkuar, sepse kjo çështje shkon përtej politikës. Si popull, në këto momente duhet t'i lëmë mënjanë ndasitë dhe të bëhemi bashkë, pasi vetëm kështu mund të ecim përpara, ta zhvillojmë vendin dhe të ndërtojmë një shtet demokratik që përparon. Familja jonë dhe pjesa e ekipit mbrojtës do ta apelojnë çdo vendim të padrejtë. Mendoj se gjithçka duhet pritur me qetësi e maturi dhe duhet parë se çfarë do të ndodhë nesër. Nuk ka prova apo dëshmi që e inkriminojnë luftën e UÇK-së, ndaj çdo vendim tjetër përveç pafajësisë së tyre do të ishte politik dhe i padrejtë", tha Krasniqi.

Seanca për shpalljen e vendimit të shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit do të fillojë nesër në orën 10:00.

Shtuar më 15.09.2026 20:04

Tags: [Altini](#), [Krasniqi](#), [vendimi](#)



AAK diskuton zhvillimet politike dhe vendimin e pritshëm në Hagë



Masa të shtuara sigurie në Hagë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së



Liadrovcit fton qytetarët e Drenasit ta presin së bashku vendimin e Hagës



Jeton Zulfaj rrimërohet kryenegociator i Kosovës për integrimin në BE



Kurti cakton zëvendësministrat e rinj në Qeverinë e Kosovës



Kostoja e përballimit të mbrojtjes ligjore për të akuzuarit në Hagë nga...



Agon Dobruna vijon mandatin si zëvendësministër i parë ...



Në shkollat e Prishtinës, ora e parë nesër do t'i kushtohet historisë së...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com